

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË AUTORITETIN RRUGOR SHQIPTAR

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Autoritetin Rrugor Shqiptar, për Projektin “Ndërtimi i rrugës Levan-Vlorë ” me objekt “Për auditimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë financiare dhe vlerësimin e zbatimit të projektit” për periudhën nga fillimi i projektit deri më 31.12.2011, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 119 datë 30.08.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 465/7 datë 03.08.2012, dërguar Z. [REDAKTUAR] Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Rrugor Shqiptar, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. NJZP/PIT në bashkëpunim me ARSH dhe MPPT , të marrë masa për të zbatuar grafikun e punimeve dhe të ndjekë procedurat për bërjen e rialokimeve të fondeve të mbetura nga kredia e BEI.
2. Te merren masa nga ana e NJP/PIT , ARSH, MPPT në bashkëpunim me MF, për të siguruar burimet financiare për të financuar koston shtesë në shumën 16 milion euro për të përfunduar punimet në segmentin rrugor Levan-Vlorë.
3. Njësia e Zbatimit të Projektit dhe Inxhinieri [REDAKTUAR] t'i kërkojnë Kontraktorit paraqitjen e një programi të rishikuar të punimeve, me përkushtimin e mjaftueshëm për të arritur përfundimin e tyre sipas afatit të përcaktuar në marrëveshjen e mirëkuptimit.
4. Bazuar në marrëveshjen e mirëkuptimit, por edhe në stadin aktual të punimeve, Njësia e Zbatimit të Projektit dhe Inxhinieri duhet të bëjnë paralajmërimet për aplikimin e penalteteve, për mos përfundim në afat të punimeve të kontratës.
5. Njësia e Zbatimit të Projektit dhe Inxhinieri [REDAKTUAR] t'i kërkojnë Kontraktorit riparimin e sipërfaqes së betonit në nënkalimin afër Fabrikës së Kripës dhe tombino drejtkëndëshe ngjitur me nënkalimin e trenit, sipas përcaktimeve në specifikimet teknike.
6. Njësia e Zbatimit të Projektit dhe Inxhinieri t'i kërkojnë Kontraktorit, realizimin e bojatisjes së shtyllave metalike të zhvendosura në kilometër 21+310 dhe kilometër 35+246, sipas kushteve teknike.
7. Njësia e Zbatimit të Projektit dhe Inxhinieri t'i kërkojnë Kontraktorit, rivendosjen e parrakëve metalikë anësorë në km 27+500 dhe km 33+900, si dhe e pllakave të tejudkshme në panelet e mbrojtjes së Lagunës së Nartës, pasi këto punime nuk janë dorëzuar akoma dhe janë në përgjegjësinë e Kontraktorit.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Bazuar në Pikën 14.6 të kushteve të përgjithshme të kontratës së punimeve civile “Ndërtim i rrugës Levan-Vlorë”, në certifikatën ndërmjetëse progresive pasardhëse, Njësia e Zbatimit

të Projektit dhe Inxhinieri duhet të zbresin vlerën **37,742 Euro**, përfituar padrejtësisht nga Kontraktori [REDACTED] për sigurimin e sipërfaqeve të lëmuara në realizimin e kanaleve anësore të betonit, realizuar nga kilometër 34+970 deri në kilometër 43+519.

2. Bazuar në Pikën 14.6 të kushteve të përgjithshme të kontratës së punimeve civile “Ndërtim i rrugës Levan-Vlorë”, në certifikatën ndërmjetëse progresive pasardhëse, Njësia e Zbatimit të Projektit dhe Inxhinieri duhet të zbresin vlerën **22,008.4 Euro**, përfituar padrejtësisht nga Kontraktori [REDACTED] llogaritur si peshë e unazave të çelikut të vendosura në Urën e Levanit.

3. Bazuar në Pikën 14.6 të kushteve të përgjithshme të kontratës së punimeve civile “Ndërtim i rrugës Levan-Vlorë”, në certifikatën ndërmjetëse progresive pasardhëse, Njësia e Zbatimit të Projektit dhe Inxhinieri duhet të zbresin vlerën **5,195 Euro**, përfituar padrejtësisht nga Kontraktori [REDACTED] për punime të pa realizuara në kanalet e betonit (mos ndërtimi i fugave).

4. Bazuar në Pikën 14.6 të kushteve të përgjithshme të kontratës së punimeve civile “Ndërtim i rrugës Levan-Vlorë”, në certifikatën ndërmjetëse progresive pasardhëse, Njësia e Zbatimit të Projektit dhe Inxhinieri duhet të zbresin vlerën **1,100.9 Euro**, përfituar padrejtësisht nga Kontraktori [REDACTED] për punime betoni të vendosjes së tombinove në rrugën e hyrjes në autostradë nga Levani.

C. MASA DISIPLINORE

1. Mbështetur në udhëzuesit përkatës, Autoriteti Rrugor Shqiptar të shpallë si të papranueshëm në lidhjen e kontratave të mëtejshme për shërbime konsulente Kompaninë [REDACTED]

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Artan Topjana, Luljeta Shtylla, Andi Buza, më tej u shqyrtua nga K/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Athanas Karaja, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Erjon Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHETIT